Mbështesim zhvillimin e kompetencave transkulturore për profesionistët e shëndetit në Ballkanin perëndimor.

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB

SHKOLLË DIMËRORE

9-13 Shkurt 2026
Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Albania



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Skenar simulimi klinik- 1



- Tema e skenarit

Marrja në konsideratë e dallimeve kulturore në kujdesin emergjent për pesë të rinj migrantë në Shqipëri

- Konteksti

Në repartin e urgjencës së spitalit rajonal të Gjirokastrës, në orën 2 të mëngjesit, dy oficerë patrullimi shoqërojnë një grup prej pesë emigrantësh të rinj meshkuj që u vunë re prej tyre në rrugën kombëtare që të çon në kufirin grek.

Skenar simulimi klinik- 1
Konteksti



- Emigrantët kanë prejardhje të ndryshme: dy prej tyre janë nga Siria, dy nga Afganistani dhe një nga Pakistani.
- Ata kanë shqetësime të shumta shëndetësore, duke përfshirë lëndime, dehidratim dhe probleme psikologjike si ankth, depression dhe nervozizëm. Dy prej tyre flasin vetëm disa fjalë në gjuhën shqipe, të gjithë flasin disa fjalë në anglisht, prandaj ndihen më rehat në gjuhët e tyre amtare. Nuk ka asnjë përkthyes të gjuhëve të tyre amtare në dispozicion në spital.

Skenar simulimi klinik- 1
Rolet



- **Pacienti 1** ka një dëmtim traumatik të kyçit të dorës së djathtë, kyçi i dorës është i ënjtur dhe i dhimbshëm.
- **Pacienti 2** ka një dëmtim traumatik të shpatullës së majtë dhe shpinës, ai ka dhimbje në pjesën torakale të shpinës dhe në shpatullën e majtë.
- **Pacienti 3** ka dy çarje në secilin prej parakrahëve të cilat rrjedhin gjak. Burri është i irrituar, ka dhimbje koke dhe një dridhje të lehtë.
- **Pacienti 4** ndihet i dobët, duket i zbehtë, ka dhimbje koke, dhimbje barku dhe ka vjellë gjak.
- **Pacienti 5** ka një dëmtim traumatik në pjesën temporale të djathtë të kafkës dhe në veshin e djathtë. Ai gjithashtu ndihet i dëshpëruar dhe i pafuqishëm

Skenar simulimi klinik- 1



- **Rolet**
- Pacientët 1 dhe 2 janë 24 dhe 26 vjeç, nga Siria. Ata flasin arabisht dhe kanë ikur nga lufta në vendin e tyre. Kanë qenë në Shqipëri për 4 ditët e fundit. Flasin disa fjalë në shqip dhe në anglisht. Ata nuk pranojnë të marrin kujdes shëndetësor nga stafi femëror.
- Pacientët 3 dhe 4 janë 22 dhe 25 vjeç, nga Afganistani. Ata flasin pashto dhe janë larguar nga vendi i tyre për shkak të mungesës së stabilitetit politik, konfliktit dhe krizës ekonomike. Ata kanë qenë në Shqipëri për javën e fundit. Flasin disa fjalë në anglisht. Pacienti 4 është skeptik në lidhje me një tub nazogastrik që i është futur në stomak.
- Pacienti 5 është 28 vjeç, nga Pakistani. Ai flet urdu dhe është larguar nga vendi i tij për shkak të varfërisë. Ai flet disa fjalë në anglisht. Ai është shumë i trishtuar dhe mezi komunikon me stafin.

Skenar simulimi klinik- 1



- **Diskutim**
- Çfarë lloj ndjenjash ngjalli simulimi?
- Cilat janë mendimet tuaja për mënyrën se si e menaxhuat atë?
- Çfarë mësuat prej tij?
- Çfarë ishte e vështirë për ju të arrini?

- **VLERËSIMI dhe ANALIZA**

  Për pjesëmarrësit në simulim:
- Çfarë lloj çështjesh kulturore dolën në pah?
- Çfarë lloj ndërhyrjesh infermierore ishin të nevojshme?
- Çfarë do të bënit ndryshe? Pse?

Skenar simulimi klinik- 1



- **Diskutim**

  Për vëzhguesit:

  Çfarë bënë mirë?

  Çfarë mund të ishte bërë më mirë?

- **PËRFUNDIME DHE ZBATIMI NË PRAKTIKË**

Çfarë mund të mësohet nga simulimi për një situatë të ngjashme në jetën reale?

Si do ta zbatoni atë që keni mësuar?